

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kurti për ceremoninë e Mlladiqit: Serbia ka kaluar në adhurim shtetëror të gjenocidit - Dukagjini
ADRESA	https://www.dukagjini.com/kurti-per-ceremonine-e-mlldiqit-serbia-ka-kaluar-ne-adhurim-s-hteteror-te-gjenocidit/
BURIMI	dukagjini.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	8 shtator 2026, 16:46:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	8 shtator 2026, 10:56:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	70fc95380d7dca19261e631de98a53ed4556656d9d48f4ebc45cc2240c3b55b1
TEKSTI	8d86ca40644e90dfb6409853bcdcfca566710b9afcea2b41699465f02c952c0a
PAMJA	2d633116fa05907a4c261e05d1e0a0d2e2bbfb09c897ad21fd829d1fc4e68172

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e0ea41206e9e65d9958ab0c77ced6a0134e3f72d3c4514613c659657c8c2d9a2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3909e366fa48fb117e93d2c07d0f8b111d83fbadbc5fe5fb3b2f1229006811f8
ANKORUAR	Polygon PoS · bllok 47086362
TRANSAKSIONI	0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2
IPFS	QmPaaZwj1okxYLPabeomTi5cMGDgWfX7SsfmVP9RJAeWDo



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e0ea41206e9e65d9958ab0c77ced6a0134e3f72d3c4514613c659657c8c2d9a2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ballina Lajme

Kurti për ceremoninë e Mlladiqit: Serbia ka kaluar në adhurim shtetëror të gjenocidit

Nga Portali Dukagjini | 8 Shtator, 2026, 12:56 |



Shija e redaktorit >



Një dekadë nga shenjtërimi i Nënë Terezës, simbolit botëror të...



Ali Ahmeti thirrje për Marshin për Liri: Më 12 shtator...



FC Prishtina mbështetë "Marshin për Liri" më 12 shtator, në...

Varrimi me ceremoni shtetërore në Serbi i kriminelit serb, Ratko Mlladiq, të dënuar për krime lufte dhe gjenocid, tregon se Serbia ka kaluar në "adhurim shtetëror të gjenocidit", ka deklaruar kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti.

Përmes një shkrimi në Facebook, Kurti ka kritikuar ceremoninë e organizuar për Mlladiqin, duke e lidhur atë me mënyrën se si Serbia, sipas tij, i trajton figurat e së kaluarës së luftës.

"Nga varrimi i priftit serb Nikolaj Velimiroviq në maj 1991 e deri te varrimi i Ratko Mlladiqit në shtator 2026, Serbia organizon spektakle morbide për gjakderdhje të ardhshme", ka shkruar Kurti.

Ai ka kritikuar edhe pjesëmarrjen e klerit fetar në ceremoninë e varrimit.

"Me shërbimin e përbotur fetar të djeshëm të Patriarkut Porfirije te kufoma e Ratko Mlladiqit, Serbia po konfirmohet si teokraci militariste ku politikanët e tyre ftohen për tifozeri klubesh të ndryshme të ligës së njëjtë", ka deklaruar Kurti.

Në fund, kryeministri në detyrë ka thënë se veprimet e fundit të Serbisë shkojnë përtej mohimit të krimeve.

"Që nga dita e djeshme, mohimi është fjalë e pamjaftueshme. Serbia ka kaluar në adhurim shtetëror të gjenocidit", ka shkruar ai.

Kurti ka kujtuar gjithashtu se Ratko Mlladiq është shpallur fajtor për gjenocidin në Srebrenicë, ku në vitin 1995 u vranë mbi 8 mijë boshnjakë.

Kurti ka krahasuar ngjarjet e shënuara ditëve të fundit në Kosovë me ceremoninë shtetërore në

Serbi për Mlladiqin, i cili është dënua nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë për krime të luftës, përfshirë gjenocidin në Srebrenicë.

Ai ka përmendur 27-vjetorin e themelimit të Policisë së Kosovës, 29-vjetorin e vdekjes së Nënë Terezës dhe 10-vjetorin e shenjtërimit të saj, si dhe Ditën e Kushtetutës së Kaçanikut.

Në anën tjetër, Kurti ka kritikuar ashpër Serbinë për ceremoninë e organizuar për Mlladiqin.

“Shteti që për vite nuk e dorëzoi te drejtësia, dje e solli kufomën e tij me aeroplan qeveritar, e mbështolli me flamur dhe e përcolli me ushtri, ministra, klerikë të lartë e orkestër”, ka shkruar Kurti.

Sipas tij, një veprim i tillë tregon se mohimi i gjenocidit ka kaluar në një nivel tjetër.

“Kështu mohimi i gjenocidit kaloi nga deklarata politike në liturgji shtetërore”, ka deklaruar Kurti.

Ai ka përmendur edhe vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të vitit 2007, duke theksuar se Serbia kishte dështuar në përbushjen e detyrimit për parandalimin e gjenocidit në Srebrenicë dhe për bashkëpunim me Tribunalin.

Në fund të postimit, Kurti ka thënë se zhvillimet e fundit në Serbi paraqesin, sipas tij, një shkallë të re të glorifikimit të krimeve të luftës.

“Mohimi është fjalë e pamjaftueshme. Serbia ka kaluar në adhurim shtetëror të gjenocidit”, ka përfunduar Kurti.

Të fundit nga rubrika >



Nënkrjetarja e Prishtinës Musmurati zbulon muralin e krerëve të UÇK-së



Shala: Pas konstituimit, partitë do të kenë 60 ditë për të reflektuar për...



Deliu-Kodra për rezultatet në PISA: Alarm për pozitë e opozitë



MINTI vendos masë antidamping ndaj farës së grurit të importuar nga...



Daka: Edhe për të shkua në zgjedhje, fillimisht duhet të konstituohet...

DUKAGJINI

Lajme
Kulturë

Sport
Ekonomi

Pikëpamje
Teknologji

Art jete
Udhëtime